



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:244527

Datë: 18.11.2024

Numri i dokumentit: 06467890

2024:244528

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me pjesëmarrjen e sekretares juridike Indira Beqa, në lëndën penale ndaj të pandehurit R.J nga fsh...-Ferizaj, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP.II.nr.883/24 të dt.30.08.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 13.11.2024, në prezencë të Prokurores së Shtetit, Mimoza Sylja-Hyseni, të dëmtuarit dhe të pandehurit, me dt.15.11.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt.18.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri R.J nga fsh...-Ferizaj, i lindur më dt.... nga i ati R... dhe e ëma T..., e gjinisë Sh..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i divorcuar, prind I tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes se mesme ekonomike, me nr.personal:...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 18.03.2024, në magjistralen Kaçanik -Hani i Elezit, saktësisht në kompaninë e dhënies së veturave me qira “...” pronë e të dëmtuarit I. J., i pandehuri me qëllim të përfitim të kundërligjshëm, siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, dhe shmang pagesën, në atë mënyrë që i njëjti fillimisht merr një veturë me qera të markës “...” me ngjyrë të zezë, me targa ..., në shfrytëzim për një afat 30 ditor dhe bën pagesën në vlerë rreth 900.00 Euro, e pas kalimit të kohës i pandehur i kërkon të dëmtuarit që të vazhdojë kontratën edhe për 26 ditë të tjera, e për të cilat ditë nuk e kryen pagesën për shërbimin e kërkuar, dhe i njëjti largohet pa lejen e të dëmtuarit për në shtetin e Francës, ku pas kësaj i pandehuri e njofton të dëmtuarin se vetura gjendet në shtetin e Francës dhe atje do t’ia kryente pagesën, por që kjo nuk kishte ndodhur dhe të dëmtuarit i kishte shkaktuar dëm material.

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 4 të KPRK- së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,42,69,70 dhe 71 par.1 nenpar.1.3, të KPRK-se, si dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 150 ditësh, I cili dënim do të ekzekutohet pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë .

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 20.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

I dëmtuari I. J. nga Kaçaniku, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzen PP.II.nr.883/24 të dt.30.08.2024, të pandehur R.J nga fsh. -Ferizaj, e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 4 të KPRK- së.

Në bazë të kesaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me dt. 13.11.2024.

Prokurorja e shtetit, Mimoza Syla-Hyseni në fjalën e saj, me rastin e prezentimit të aktakuës, deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate.

I dëmtuari, I. J në fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar, I bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore juridike në vlerë prej 2090 €.

I pandehuri në fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se, e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se, arsyeja që ishte vonuar në kryerjen e pagesave të shërbimeve, ishte gjendja jo e mirë shëndetësore e tij dhe se të hollat për pagesën e shërbimeve për automjetin i kishte dhënë djalit të tij ,por që ky i fundit nuk i'a kishte dhënë të hollat të dëmtuarit por i kishte hargjuar vetë, për çka normalisht që e ndien veten keq dhe i premtonte gjykatës se veprime të tilla me nuk do të perseriten në të ardhmen, dhe po ashtu shpreh gatishmëri që të kompenzojë të dëmtuarin për dëmin e shkaktuar. Derisa shton se është e vërtetë që ky automjet ka lëvizur vazhdimisht, por nuk e ka drejtuar vetë, por e ka drejtuar djali i tij, për shkak të gjendes jo të mirë shëndetësore të tij .

Prokurorja e shtetit në fjalën e tij është dakorduar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 242 të KPP-së, andaj edhe I propozon gjykatës që të pranohet pranimi i fajësisë për të pandehur dhe t'i shqiptohet sanksion penal sipas ligjit.

I dëmtuari në fjalën e tij poashtu pajtohet me pranimin e fajësisë nga I pandehuri, por nuk pajtohet me arsyetimin e tij, pra të pandehurit, lidhur me gjendjen jo të mirë shëndetësore, sepse I dëmtuari thot se I pandehuri ka lëvizur non stop me automjet, fakt që I vërtetuar përmes GPS-it të automjetit në fjalë, dhe se ditën kur kishte shku për t'a marrë automjetin në vendin e

caktuar, I pandehuri nuk l'a kishte dorëzuar automjetin personalisht, dhe këtë të fundit, edhe pse e kishte pritur edhe dy ditë që të takohen, nuk kishte arritur që të takohet me te.

Pas dëgjimit të palëve, gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 1 të KPRK-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajesisë, se pranimi i fajesisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me këtë gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform neni 70 të KPRK-së, kështu që si rrethane lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në tërësi në shqyrtimin fillestar, duke shprehur keqardhje dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa rrethanë të posaqme rënduese, gjykata pati parasysh faktin se, bazuar në evidencën e gjykatës, kopja e së cilë i është bashkangjitur shkresave të lëndës, i njëjti në të kaluarën ka patur edhe katër raste penale për të cilat është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin R.J, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074, e gjykoji me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitivin e neni 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore jurididike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK
2024:244528 datë 18.11.2024

Sekretarja Juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.